

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

# Programi mësimor

*ARSIMI PROFESIONAL*

Programi 2008

## Mekatronikë

Niveli I dhe II



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva Obrazovanja Nauke i  
Tehnologije-Ministry of Education Science &Technology*

**Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister**

***UDHËZIM ADMINISTRATIV***

***ZBATIMI I PLANIT DHE PROGRAMIT PËR ARSIMIN PROFESIONAL FUSHA:  
ENERGJETIKË, ELEKTROTEKNIKË, PËR NIVELIN E PARË (KL.X, XI)***

**NUMËR: 20/2008**

**DATË : 19.8.2008**

Në bazë të Kapitullit VI, neneve 93 (4) dhe 97 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6.1 paragrafi (d) të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë nenit 6, 8, 11 të Ligjit mbi Arsimin dhe Aftësimin Profesional, si dhe nenit 25 paragrafit 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ (më tutje UA):

**Neni 1**

**Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi është zbatimi i planit dhe programit mësimor për shkollat profesionale, nivelin e parë (kl.X, XI).

**Neni 2**

**Planprogrami**


Plani dhe programi i ri për nivelin e parë (kl.X,XI) fusha: *Energjetikë, profilet: energjetikë, makina elektrike dhe fusha Elektroteknikë, profilet: informatikë, komunikime video dhe audio, telekomunikacion ,mekatronikë*, i është bashkangjitur këtij Udhëzimi administrativ.

**Neni 3**  
**Zbatueshmëria**

Me zbatimin e planit dhe programit të nivelit të parë, zëvendësohen planet dhe programet e deritashme të kl. X,XI.

**Neni 4**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me fillimin e vitit shkollor 2008/2009.



Enver Hoxhaj, ministër

## Parathënie

Shoqëritë bashkëkohore arsimin e konsiderojnë ndër pasuritë më të rëndësishme të njerëzimit dhe përpiqen të gjurmojnë potencialin e tij të plotë, në mënyrë që t'u ndihmojnë njerëzve të ballafaqohen me sfidat e botës së sotme.

Pas një krize të gjatë, shoqëria kosovare sot ballafaqohet me një sfidë të re për t'iu bashkangjitur rrjedhave aktuale të zhvillimit ndërkombëtar. Në sferën e arsimit, reforma e planprogramit është një reagim ndaj zhvillimeve të reja në shoqërinë kosovare. Procesi i reformës së planprogramit synon rritjen e cilësisë së arsimit dhe barazisë në gëzimin e dobive që ofron ai për të gjithë nxënësit dhe inkuadrimin e sistemit të arsimit në rrjedhat aktuale që kanë të bëjnë me reformat e arsimit në sistemet tjera të përparuara. Nevojat e përhershme për ristrukturimin e shkollimit dhe për ripërkufizimin e qëllimeve dhe objektivave të tij, lidhen me ndryshimet që shfaqen në shoqëri, ekonomi, politikë, shkencë e teknologji.


Që nga fillimi i veprimtarisë në Kosovë, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) reformën e vet e ka mbështetur në dy shtylla: (a) përfshirja e ekspertëve, specialistëve dhe konsulentëve vendorë për zhvillimin e strukturave të reja, dhe (b) angazhimin e agjencive ndërkombëtare e vendore, të cilat ndihmojnë Ministrinë në sajimin dhe zbatimin e programeve të reja në sistemin e ri të arsimit në Kosovë.

Në planprogramet për arsimin profesional të Kosovës gjerësia dhe thellësia e formimit të nxënësve shikohen si një proces integral që përmbledhë dimensionin e përgjithshëm të njeriut, dimensionin shoqëror të qytetarit dhe dimensionin profesional të punëtorit, të pajisur me dije, shprehje dhe vlera të shumëfishta. Nxënësit do të ndjekin lëndë të përgjithshme dhe profesionale. Në këtë mënyrë, MASHT synon të zhvillojë një kulturë të përgjithshme unike për të gjithë nxënësit që përfundojnë shkollat teknike e profesionale.

Programet e reja të lëndëve të përgjithshme, së bashku me ato të lëndëve e të praktikave të ndryshme profesionale, do të sigurojnë një formim bashkëkohor, sa i përket kulturës së përgjithshme dhe profesioneve të ndryshme, duke synuar të përgatisin brezin e ri si qytetarë të ardhshëm të një shoqërie kosovare të lirë e demokratike, të aftë për t'u ballafaquar me sfidat e zhvillimit kulturor e ekonomik dhe me kërkesat e tregut të punës në shkallë vendi, rajoni e më gjerë.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë i fton të gjithë mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave profesionale, specialistët, prindërit, nxënësit dhe të gjithë të interesuarit për zhvillimin e sistemit të Arsimit të Mesëm Profesional të Kosovës të japin ndihmesën e tyre për ngritjen e nivelit të këtyre shkollave në nivel të shkollave përkatëse evropiane e më gjerë, sa u përket parametrave e standardeve.

Shfrytëzojmë rastin ti falënderojmë të gjithë ata që me përkushtim të madh punuan në këtë dokument dhe donatorët që kanë ndihmuar dhe përkrahur procesin e zhvillimit të planprogramit deri në këtë fazë.

  
Enver Hoxhaj, ministër

# PËRMBAJTJA

- I. Korniza e programit mësimor profesional për profilin “Mekatronikë”, niveli I dhe II.**
- II. Programet e lëndëve profesionale dhe përshkruesit e moduleve të praktikave profesionale për nivelin I**
  - a) Programet e lëndëve profesionale, kl. 10.**
    - 1. Bazat e elektroteknikës
    - 2. Materiale teknike
    - 3. Vizatim teknik me dokumentacion
    - 4. Bazat e mekanikës teknike
  - b) Përshkruesit e moduleve të praktikave profesionale, kl. 10.**
    - 1. Realizimi i skemave elektrike dhe matja e madhësive elektrike.
    - 2. Veprime praktike me kompjuterët personalë
    - 3. Mbrojtja dhe siguria në punë
    - 4. Punime axhusterie
  - c) Programet e lëndëve profesionale, kl. 11.**
    - 1. Bazat e elektroteknikës
    - 2. Matje elektrike
    - 3. Bazat e elektronikës
    - 4. Mekanika precize
    - 5. Bazat e programimit
  - d) Përshkruesit e moduleve të praktikave profesionale, kl. 11.**
    - 1. Matja në elektronikë
    - 2. Pajisjet për shtrëngim dhe mbajtje
    - 3. Prekje dhe sharritje
    - 4. Tornim
    - 5. Saldim
- III. Programet e lëndëve profesionale për nivelin II.**
  - a) Programet e lëndëve profesionale, kl. 12.**
    - 1. Elektronikë digjitale
    - 2. Pneumatika
    - 3. Teknika CAD dhe PLC
    - 4. Sensorika
  - d) Përshkruesit e moduleve të praktikave profesionale, kl. 12.**
- IV. Literatura e rekomanduar**

# Korniza e programit mësimor profesional

*ARSIMI PROFESIONAL*

Programi 2008

## Mekatronikë

**Niveli I dhe II**

# **Korniza e programit mësimor profesional**

**Lëmi:** Elektroteknikë

**Profili:** Mekatronikë

**Niveli:** I dhe II

## **I. Njoftime të përgjithshme për shkollimin**

### ***1. Struktura e shkollimit***

Arsimimi në profilin mësimor “ Mekatronikë” trajtohet në kuadrin e shkollimit të mesëm të lartë dhe ofrohet në shkollat profesionale, në tri nivele:

- ***niveli i parë*** e arsimimit profesional, me kohëzgjatje dy vite mësimore (kl. 10 dhe 11), i përgatit nxënësit për nivelin fillestar (hyrës) të punësimit në profesionin e Mekatronikës. Jep një çertifikatë të përgatitjes profesionale të nivelit të punëtorit të gjysmëkualifikuar dhe mundëson kalimin në nivelin e dytë të arsimimit profesional.
- ***niveli i dytë***, me kohëzgjatje një viti mësimor (kl. 12) pas përfundimit me sukses të shkallës së parë, i përgatit nxënësit për të fituar një kualifikim profesional që u mundëson atyre integrimin në tregun e punës si dhe vazhdimin e studimeve në shkallë më të larta. Jep një çertifikatë të përgatitjes profesionale të nivelit të punëtorit të kualifikuar dhe mundëson kalimin në nivelin e tretë të arsimimit profesional ose në kurset urë (një vjeçare) që lejojnë kalimin në studimet universitare ose post-sekondare.
- ***niveli i tretë***, me kohëzgjatje një vit mësimor (kl. 13) pas përfundimit me sukses të shkallës së dytë, i përgatit nxënësit për të fituar një kualifikim profesional me mundësi të mëdha integrimi në tregun e punës si dhe me mundësi për vazhdimin e studimeve të mëtejshme. Jep një çertifikatë të përgatitjes profesionale të nivelit të punëtorit me shkathësi të larta dhe mundëson kalimin në studimet universitare ose post-sekondare.

Ky dokument përmban kurrikulin e profilit mësimor “ Mekatronikë”, vetëm për shkallët I dhe II, dhe është i strukturuar në lëndë mësimore (teorike) dhe module mësimore (praktike) të ndara në tri grupe kryesore:

- ***grupi i lëndëve të përgjithshme***, që synojnë formimin shkencor - humanitar të nxënësve për të lehtësuar integrimin e tyre në shoqëri si dhe vazhdimin e shkollimit të mëtejshëm.
- ***grupi i lëndëve teorike-profesionale***, që synojnë konsolidimin te nxënësit, të koncepteve shkencore, si dhe bëjnë njohjen e tyre me proceset teknike-teknologjike që lidhen me profesionin e Mekatronikës.
- ***grupi i moduleve të praktikës profesionale***, që synojnë përgatitjen e nxënësve me kompetencat praktike të nevojshme për t'u integruar me sukses në tregun e punës.

### ***2. Qëllimet e përgjithshme të shkollimit***

Qëllimi kryesor i shkollimit (dynivelësh) për Mekatronikë është zhvillimi i personalitetit të nxënësve për t'u inkuadruar në një shoqëri demokratike si qytetarë aktivë e kompetentë, si dhe për t'u angazhuar me sukses në tregun e punës gjithnjë në ndryshim. Sfidat të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi janë dhe zhvillimi te nxënësit i ndjenjës së vetbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gadishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t'u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe profesionale.

Për të realizuar këto qëllime, është e nevojshme që shkolla profesionale t'u krijojë nxënësve:

- Mundësi të përshtatshme për të nxënë pavarësisht nga gjinia, raca, etniteti dhe aftësitë fizike e mendore;
- Mundësi për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë dhe qëndrimet - vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e aftësimin profesional të mëtejshëm;
- Kushte për të njohur dhe zbatuar rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Kushte për t'u njohur me teknologjitë dhe proceset teknologjike aktuale e të perspektivës, në fushën e mekatronikës;
- Lehtësi për të kuptuarit e mjedisit shoqëror dhe ekonomik, lokal, kombëtar dhe rajonal, si dhe për të qenë të vetëdijshëm për rolin që mund të luajnë në shoqëri.
- Mbështetje për të zhvilluar ndjenjen e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe vlerat morale;
- Kushte për t'u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale.
- Mbështetje për të çmuar me realizëm vlerat dhe potencialin e tyre dhe për të marrë përgjegjësi në procesin e zhvillimit të tyre të vazhdueshëm personal dhe profesional.
- Mbështetje për të zhvilluar format e bashkëpunimit dhe besimit të ndërsjellët nëpërmjet përvojës së punës praktike.
- Mundësi për t'u njohur me zhvillimet perspektive të profesionit të tyre, të para këto në kontekstet e integritit evropian.

### **3. Grupi të cilët i drejtohet shkollimi**

Shkollimin për “Mekatronikë”, niveli I dhe II, mund ta ndjekin **të gjithë të rinjtë dhe të rejtat** të cilët kanë përfunduar me sukses arsimin e detyruar nëntëvjeçar, janë në moshë deri 24 vjeç dhe zotërojnë aftësi shëndetësore (fizike e mendore) të mjaftueshme për të kryer këto nivele shkollimi.

Në raste të veçanta, kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se sa kapacitetet reale të shkollave profesionale, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) përgatit udhëzime të veçanta me kritere pranimit të posaçme për këto shkolla.

### **4. Mundësitë e shkollimit të mëtejshëm**

Përfundimi me sukses i shkollimit për profilin mësimor “Mekatronikë” në nivelin I, i lejon nxënësve vazhdimin e shkollimit në nivelin II të këtij profili.

Përfundimi me sukses i shkollimit për profilin mësimor “Mekatronikë”, niveli II, i lejon nxënësve vazhdimin e shkollimit në nivelin III (të punëtorit me shkathtësi të larta) në të njëjtën lami ose profil, për të fituar diplomën e maturës profesionale, me të drejtë kalimi në shkollimin e lartë universitar. Një mundësi tjetër të mekatronikës të nivelit II është ndjekja e kurseve urë, me të drejtë kalimi për në shkollimin e lartë universitar.

### **5. Mundësitë e punësimit**

Shkollimi për “Mekatronikë”, niveli I dhe II, i referohet punëve në ndërmarrjet që merren me ofrimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me pajisjet mekatronike që janë aktuale dhe shihen me përparësi për të ardhmen në tregun e Kosovës, siç janë: pajisjet industriale (aparartet, veglat, linjat e montazhit etj.); teknika e zyrës, pajisjet për argëtim, videokamerat, fotoaparartet

elektronike, aparatet shtëpiake bashkëkohore; automjetet; instrumentet, pajisjet e mjekësisë, sensorët. Nisur nga kjo, Mekatroniku i nivelit I dhe II mund të punësohet në ndërmarrje (firma, kompani) që të instalojë, të mirëmbajë dhe të riparojë aparatet e pajisjet mekatronike, ose mund të vetëpunësohet si mirëmbajtës ambulant (shëtitës), në këtë sektor, sipas kërkesave të klientëve. Me kualifikime të mëtejshme dhe pas një përvoje pune të konsiderueshme, ai mund të krijojë një biznes të vetin në këtë sektor dhe të punësojë të tjerë.

## **II. Kompetencat e fituara nga nxënësit në përfundim të shkollimit**

### **1. Kompetencat e përgjithshme**

Ndjekja e shkollimit në profilin mësimor “Mekatronikë”, *niveli I*, do të zhvillojë te nxënësit një tërësi kompetencash të përgjithshme të cilat do t’i shërbejnë atij në përvetësimin e me efektivitet të programit mësimor, zhvillimin në nivelin e kërkuar të kompetencave profesionale dhe integrimin e mëtejshëm në shoqëri dhe në tregun e punës gjithnjë në ndryshim. Këto kompetenca të përgjithshme do të zhvillohen në një nivel më të lartë gjatë kryerjes së shkollimit për “Mekatronikë”, *niveli II*. Kështu, nxënësi do të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte, me shkrim dhe me gojë, për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme (përfshirë dhe ato të kompjuterizuara) të mbledhjes dhe shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në zgjidhjen e situatave të ndryshme problemore që do të ndeshë në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të manifestojë qasje të një kritike konstruktive ndaj zhvillimeve profesionale, personale dhe shoqërore.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm për kërkim të vazhdueshëm në drejtim të zgjidhjeve të reja, më efektive dhe më eficiente.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale dhe globale.
- Të manifestojë guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësisë për të ardhmen e tij.
- Në kontekstin e pavarësisë në vendim-marrje, të tregojë vet-kontroll në ushtrimin e veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë e vullnetin për një të nxënë që zgjat gjithë jetën.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vet-vlerësojë nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet.

### **2. Kompetencat profesionale**

Me përfundimin e suksesshëm të shkollimit dyvjeçar në Profilin mësimor “Mekatronikë”, *niveli I*, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Lexon dhe interpreton skema dhe dokumentacionin teknik të pajisjeve mekatronike.
- Përgatit vendin e punës.
- Përzgjedh veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për punë.
- Përdor dhe mirëmban veglat dhe pajisjet e punës.
- Respekton standardet e profesionit.
- Zbaton rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit.
- Përdor në mënyrë të pavarur literaturën me qëllim ngritjen profesionale.

Me përfundimin e suksesshëm të shkollimit të mëtejshëm njëvjeçar në Profilin mësimor “Mekatronikë”, *niveli II*, nxënësi do të rrisë në një shkallë më të lartë nivelin e kompetencave të fituara në nivelin I, si dhe do të aftësohet të ushtrojë kompetencat të tjera profesionale si më poshtë:

- Mirëmban dhe ndreq pajisjet mekatronike të: teknikës së zyrës, teknikës së mjekësisë, proceseve teknike të prodhimit, aparaturës matëse etj.
- Instalon pajisjet dhe sistemet mekatronike, siç janë: sistemet mekanike, pneumatike, hidraulike, elektrike, elektronike, sensorike, tekniko-informatike.
- Monton elementet (komponentet, detajet) në makina, pajisje të automatizuara për prodhim, linja të prodhimit etj.
- Përdor teknikat e ndryshme të përpunimit të metalit, siç janë: cilindrimi, shtrëngimi, prerja, ngjitja, saldimi, tornimi (telëzim) etj.
- Lidhë pjesët elektronike dhe mekanike.
- Kontrollon dhe mirëmban sistemet lëvizëse, sensorët, pajisjet kyçëse dhe shërbyese.
- Monton dhe programon pajisjet mbikëqyrëse.
- Përgatit kërkesat për material adekuat dhe pjesë rezervë (të ndërrimit) të nevojshme në bazë të kërkesave të rastit.
- Punon në mënyrë të pavarur për të zgjidhur probleme të natyrave të ndryshme që paraqiten në momente (situata) të caktuara.

### III. Plani mësimor për profilin “Mekatronikë”, Niveli I dhe II

Nr.	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore dhe kreditet		
		Niveli I		Niveli II
A.	Lëndët e përgjithshme	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12
1	Gjuhë shqipe dhe letërsi	3 (105)	3 (105)	3 (105)
2	Gjuhë angleze	2 (70)	2 (70)	2 (70)
3	Matematikë	3 (105)	3 (105)	3 (105)
4	Teknologji e informacionit dhe komunikimit (TIK)	2 (70)	2 (70)	2 (70)
5	Ekonomia dhe ndërmarrësia	1 (35)	1 (35)	1 (35)
6	Edukatë qytetare	1 (35)	-	-
7	Edukatë fizike	2 (70)	2 (70)	2 (70)
1	Fizikë	2 (70)	2 (70)	-
2	Menaxhim i projekteve	-	-	2 (70)
	<b>A. Gjithsej</b>	<b>16 (560)</b>	<b>15 (525)</b>	<b>15 (525)</b>
B.	Lëndët profesionale			
1	Bazat e elektroteknikës	4 (140)	2 (70)	-
2	Matjet elektrike	-	2 (70)	-
3	Materiale dhe komponente elektrike	2 (70)	-	-
4	Vizatim teknik me dokumentacion	2 (70)	-	-
5	Bazat e mekanikës teknike	2 (70)		
6	Bazat e elektronikës	-	2 (70)	-
7	Mekanika precize		2 (70)	
8	Bazat e programimit		3 (105)	
9	Elektronikë digjitale	-	-	2 (70)
10	Pneumatika	-	-	2 (70)
11	Teknikat CAX dhe PLC	-	-	2 (70)
12	Senzorika	-	-	2 (70)
	<b>B. Gjithsej</b>	<b>10 (350)</b>	<b>11 (385)</b>	<b>8 (280)</b>
C.	Modulet e praktikës profesionale			
1	Realizimi i skemave elektrike dhe matja e madhësive el.	10 (60)		
2	Veprime praktike me kompjuterët personalë	11 (66)		
3	Mbrojtja dhe siguria në punë	6 (36)		
4	Punë axhusterie	8 (48)		
5	Matje në elektronikë		11 (66)	
6	Pajisjet për shtrëngim dhe mbajtje		6 (36)	
7	Prerja dhe sharritja		6 (36)	
8	Tornim		6 (36)	
9	Saldim		6 (36)	
	<b>C. Gjithsej</b>	<b>6 (210)</b>	<b>6 (210)</b>	<b>9 (315)</b>
	Lëndët profesionale dhe modulet e praktikës, në %	50,00 %	53,13 %	53,13%
D.	Gjithsej orë në javë (A+B+C)	<b>32(1120)</b>	<b>32(1120)</b>	<b>32(1120)</b>

#### IV. Udhëzime për zbatimin e kornizës së programit mësimor profesional:

Lëndët e përgjithshme janë të njëjta për të gjitha profilet arsimore dhe programet e detajuara të tyre parashtrihen në një dokument të veçantë të MASHT.

Javët mësimore sipas klasave:

- Klasa 10 – 35 javë; Klasa 11 – 35 javë (niveli I).

- Klasa 12 – 35 javë (niveli II);

Java mësimore ka 5 ditë x 6,4 orë/ditë = 32 orë mësimore në javë.

Një orë mësimore është 45 minuta.

Si njësi e ngarkesës mësimore për praktikën mësimore do të përdoret koncepti i *kreditit (K)*, i cili do të jetë i barazvlefshëm me 6 orë mësimore (1 ditë praktike). Praktikën profesionale do të realizohen ditore ose gjysëmditore (6 orë ose 3 orë në ditë), si më poshtë:

Klasa 10: Praktikë – 1 ditë në javë dhe Teori – 4 ditë në javë

Klasa 11: Praktikë – 1 ditë në javë dhe Teori – 4 ditë në javë

Klasa 12: Praktikë – 1,5 ditë në javë dhe Teori – 3,5 ditë në javë

Rekomandohet që modulet praktike për çdo vit mësimor, të realizohen në përputhje me rradhën e paraqitur në planin mësimor. Shkollat profesionale, në vartësi të kushteve dhe situatave specifike në të cilat ndodhen, mund të bëjnë ndryshime të radhës së trajtimit të moduleve mësimore praktike, gjithnjë duke u munduar të mos e dëmtojnë procesin e përvetësimit të tyre.

Shkolla duhet të mundohet që modulet praktike t'i realizojë në formë të **bllok-orëve**, si e vetmja mënyrë e zbatimit të suksesshëm të **metodës me projekte**. Kjo duhet të realizohet kah fundi i vitit mësimor.

Mbështetur në kapitujt dhe temat mësimore të paraqitura në programet e detajuara të lëndëve profesionale, mësuesit e lëndëve teorike profesionale bëjnë planifikimin e njësive mësimore përkatëse.

Mbështetur në përshkruesit e moduleve të praktikave profesionale, mësuesit e praktikave profesionale përgatisin plane më të detajuara ku parashtrihen veprimtaritë praktike konkrete. Njëkohësisht, ata përgatisin instrumentet e vlerësimit për çdo rezultat mësimor të paraqitur në përshkruesit e moduleve.

**Vlerësimi përfundimtar** i nxënësve, në mbarim të secilës prej të dy shkallëve të përgaditjes në profilin “ Mekatronikës”, do të organizohet në formë provimesh, të fokusuara në tri drejtime kryesore:

- Provimi për lëndët e kulturës së përgjithshme.
- Provimi i integruar për lëndët e teorisë profesionale.
- Provimi i integruar për praktikën profesionale.

Rezultatet e provimeve do të pasqyrohen në **certifikatat** përkatëse të përfundimit të shkollimeve profesionale në të dy nivelet e përgatitjes.

Modalitetet e vlerësimit të nxënësve me nota, të provimeve përfundimtare dhe të përmbajtjes së certifikatave, përcaktohen me udhëzime të veçanta të MASHT.

#### V. Udhëzime të përgjithshme didaktike

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ata, të kompetencave sociale e profesionale, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve të teorisë profesionale dhe e moduleve të praktikave

profesionale, niveli e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimdhënëse etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit drejtues e mësimdhënës të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me nivelin e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre, përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit dhe instruktorët e praktikave.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollën profesionale që përgatit Mekatronikën.

Mësuesit dhe duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik apo praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti, dhe veprimtarinë sociale të qytetarit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm.

Format dhe metodat e të mësuarit janë të shumta e të shumëllojshme dhe mësuesit, në konsultim të ngushtë me njëri-tjetrin duhet të përzgjedhin ato që janë më të përshtatshme për kontekstin e tyre konkret. Të tilla janë: *ligjërata tradicionale, demonstrimi, zgjidhja e problemit teorik, ushtrimi praktik, projektet praktike, veprimtaritë në grupe të vogla etj.* Rekomandohet që në përmbajtjet teorike të përdoren kryesisht ligjërata, zgjidhja e problemit teorik dhe demonstrimi, kurse në zbatimin e moduleve praktike të përdoren kryesisht demonstrimi nga instruktori, praktika e mbikëqyrur dhe praktika e pavarur e nxënësve (metoda katërshkallëshe). **Projektet praktike**, sidomos ato që integrojnë kompetenca të lidhura me shumë aspekte të profesionit, janë një metodë që rekomandohet sidomos në stadet përmbyllëse të shkollimit. Në kushtet e mungesës së mjediseve reale të punës, duhet të synohet krijimi i mjediseve të simuluar të punës.

Për sa i përket **vlerësimit të nxënësve**, rekomandohet të përdoren metoda dhe instrumente vlerësimi që të nxisin përparimin e nxënësve, shmangin subjektivizmin në vlerësim dhe të pasqyrojnë arritjet reale të tyre. Me rëndësi është vlerësimi i vazhdueshëm dhe ai përfundimtar, ku format dhe instrumentet e vlerësimit përzgjidhen apo hartohen nga vetë mësuesit. Duhet të synohet vlerësimi i arritjeve *i bazuar në kriteret*, ku arritjet e nxënësit krahasohen me standardet e paracaktuara dhe të shmanget sa më shumë të jetë e mundur *vlerësimi i bazuar në renditjen*, ku nxënësit krahasohen me njëri-tjetrin. Format dhe instrumentet e vlerësimit që rekomandohen janë: pyetjet me gojë, pyetjet me shkrim, detyrat me shkrim, vëzhgimi i veprimtarisë së nxënësve, listat e kontrollit, projekte për vlerësim etj. Në veprimtaritë praktike, listat e kontrollit duhet të jenë instrumenti vlerësues që duhet të mbizotërojë. Mësuesi përzgjedh ato që janë më të përshtatshme, duke marrë parasysh kushtet konkrete. Edhe gjatë provimeve përfundimtare në teori profesionale dhe praktikë profesionale, në përputhje me udhëzimet përkatëse të MASHT, duhet të mbizotërojë vlerësimi i kompetencave të punës së nxënësve, të testuara në situata pune reale apo të simuluar.

Në përgjithësi, si për mësimdhënien, ashtu edhe për vlerësimin duhet të synohen forma e metoda që e vendosin nxënësin në qendër të veprimtarive mësimore dhe e shndërrojnë rolin e mësuesit nga lektor i thjeshtë, në një moderator, mbikëqyrës dhe vlerësues i veprimtarisë së nxënësve.

# Programet e lëndëve profesionale

*ARSIMI PROFESIONAL*

*Programi 2008*

## Mekatronikë

Niveli I dhe II

# Klasa 10

## Programet e lëndëve profesionale

### Programi i lëndës

#### “Bazat e elektroteknikës”

**Lëmi:** Elektroteknikë

**Profili:** Mekatronikë, Energjetikë, Makina elektrike, Informatikë, Telekomunikacion, Komunikime audio dhe video

**Niveli:** I

**Klasa:** 10

#### I. Qëllimi i lëndës

Në përfundim të kësaj lënde, nxënësi duhet të dijë:

- të tregojë qëllimin dhe rëndësinë e elektroteknikës
- të përshkruajë dukurinë e elektricitetit;
- të njohë madhësitë kryesore elektrike;
- të analizojë raportet ndërmjet madhësive elektrike në qarqe të ndryshme;
- të analizojë raportet ndërmjet madhësive elektrike të natyrës së njëjtë;
- të përshkruajë efektin e fushës elektrike në kondensatorë të ndryshëm;
- të dallojë proceset elektrike në bobinë;
- të dallojë komponentet (elementet) kryesore elektrike të rrymës së vazhduar.
- të dallojë rreziqet në punë dhe rregullat për eliminimin e tyre;

#### II. Fondi i orëve të lëndës

35 javë x 4 orë/javë = 140 orë

#### III. Programi i hollësishëm i lëndës

##### **Kapitulli 1:** Qarqet elektrike dhe parametrat e tyre

20 orë

##### **a) Qëllimet e kapitullit:**

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të dijë:

- t’i dallojë madhësitë kryesore elektrike;
- të paraqesë mënyrat e realizimit të qarqeve elektrike;
- t’i zbatojë madhësitë kryesore elektrike në një qark elektrik;
- t’i dallojë komponentet (elementet) kryesore elektrike (rezistorët, kondensatorët dhe bobinat) të rrymës së vazhduar dhe të dijë rolin e tyre;
- të shpjegojë kuptimin e rrymës e të tensionit në qarkun elektrik;
- të tregojë efektin e rrymës në trupin e njeriut dhe masat për të përballuar rreziqet;
- të analizojë raportet ndërmjet rrymës, tensionit dhe rezistencës;
- të tregojë ndikimin e rezistencës në qarkun elektrik;
- të shpjegojë metodat matëse me multimetër (voltmetër, ampermetër, ommetër) të madhësive elektrike;

- të analizojë qarkun e thjeshtë elektrik.

#### **b) Temat e kapitullit**

- Elektriciteti
- Madhësitë elektrike kryesore: tensioni, rryma, rezistenca. Rënia e tensionit.
- Qarku elektrik dhe realizimi i tij
- Burimet e rrymës së vazhduar dhe lidhja e tyre në qark (në seri dhe në paralel).
- Veprimi i rrymës elektrike (fuqia dhe energjia).
- Multimetri (voltmetri, ampermetri dhe omometri) dhe matja e madhësive elektrike.
- Rreziku nga rryma elektrike dhe masat mbrojtëse ndaj rrymave të rrezikshme për njeriun.

#### **c) Udhëzime didaktike për kapitullin**

Rekomandohet që mësuesi:

- të motivojë nxënësit duke përdorur mjete vizuale;
- të kryejë punë laboratoriale për qarqet elektrike dhe parametrat e tyre;
- të angazhojë nxënësit për ilustrimin e rasteve të goditjes nga rryma;
- të krijojë mundësi që nxënësit të përdorin katalogë me diagrame dhe tabela.
- të angazhojë nxënësit në zgjidhjen e problemeve nëpërmjet punës në grupe;
- të krijojë mundësi që nxënësit të përdorin instrumente elektrike matëse;
- të nxisë nxënësit nëpërmjet pyetje-përgjigjeve;
- t'u japë detyra nxënësve për llogaritjen e qarqeve të thjeshta elektrike;

#### **d) Kushtet për realizimin e kapitullit**

- pankarta;
- projektori;
- katalogë.
- laborator;
- makete për pajisjet;
- multimetri.

### **Kapitulli 2: Rezistorët dhe rezistenca. Ligji i Omit dhe ligjet e Kirkofit 24 orë**

#### **a) Qëllimi i kapitullit**

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet:

- të dijë të zbatojë ligjet kryesore të elektroteknikës (ligjet e Kirkofit, Ligjin e Omit etj.) në praktikë;
- të shpjegojë parimin e punës të burimeve të rrymës së vazhduar;
- të dallojë burimet e rrymës së vazhduar;
- të tregojë rregullat e lidhjes së burimeve elektrike;
- të analizojë raportet ndërmjet rrymës, tensionit dhe rezistencës;
- të tregojë ndikimin e rezistencës në qarkun elektrik;
- të shpjegojë metodat matëse me multimetër të madhësive elektrike;
- të analizojë qarkun e thjeshtë elektrik.
- të paraqesë raportet e rrymave në një nyje;
- të paraqesë raportet e forcave elektrolëvizore dhe forcave elektrozistore në një qark të mbyllur;
- të dallojë rolin e lidhjes në seri;
- të përshkruajë efektin e lidhjes në seri të llambat elektrike;
- të tregojë rolin e lidhjes paralele;
- të përshkruajë efektin e lidhjes në paralel të llambat elektrike;

- të krahasojë lidhjen në seri dhe lidhjen në paralel të rezistorëve;
- të analizojë qarqet e ndryshme me rezistorë;
- të tregojë gabimet e mundshme në qarqet e ndryshme me rezistorë.

#### **b) Tema e kapitullit**

- Ligji i Omit dhe ligji i Xhulit
- Karakteristika volt-ampere
- Matja e madhësive elektrike (tensionit, rrymës dhe rezistencës) me multimetër (voltmetër, ampermetër dhe ommetër)
- Ligji i parë i Kirkofit (ligji i rrymave)
- Ligji i dytë i Kirkofit (ligji i tensioneve)
- Burimet e rrymës së vazhduar
- Lidhja seri dhe paralele e burimeve (f.e.l., rregullat e lidhjes)
- Lidhja në seri (metoda e tensionit, rezistenca ekuivalente)
- Lidhja paralele (metoda e rrymave, rezistenca ekuivalente)
- Lidhja e kombinuar (rezistenca ekuivalente)
- Testimi i qarqeve – gabimet (rezistenca ekuivalente – lidhja e shkurtë)

#### **c) Udhëzime didaktike për kapitullin**

Rekomandohet që mësuesi të:

- të motivojë nxënësit duke përdorur mjete vizuale;
- të kryejë punë laboratorike për qarqet elektrike dhe parametrat e tyre;
- të angazhojë nxënësit në zgjidhjen e problemeve nëpërmjet punës në grupe;
- të krijojë mundësi që nxënësit të përdorin katalogë me instrumente elektrike matëse;
- të nxisë nxënësit nëpërmjet pyetje-përgjigjeve;
- t'u japë detyra nxënësve për llogaritjen e qarqeve të thjeshta elektrike;
- të angazhojë nxënësit nëpërmjet detyrave të shtëpisë për zbatimin e ligjit të Omit dhe të Xhulit.
- të kryejë punë laboratorike për lidhjet e rezistorëve;
- të angazhojë nxënësit në grupe në zgjidhjen e problemeve gjatë lidhjes së skemave elektrike;
- të kryejë llogaritje të rezistencave ekuivalente, për tensione dhe rryma;
- të bëjë matje të rrymës për qarqe të thjeshta;
- të bëjë matje të tensionit për qarqe të thjeshta;
- të zhvillojë ushtrime laboratorike me poça elektrike (rënia e tensionit).

#### **d) Kushtet për realizimin e kapitullit**

- laborator;
- pankarta;
- projektori;
- makete për pajisjet;
- katalogë;
- multimetri.

### **Kapitulli 3: Qarqet e rrymës së vazhduar**

**16 orë**

#### **a) Qëllimi i kapitullit**

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet:

- të paraqesë raportet e rrymave në një nyje;

- të paraqesë raportet e forcave elektrolëvizore dhe forcave elektrozistore në një qark të mbyllur;
- të dallojë rolin e lidhjes në seri;
- të përshkruajë efektin e lidhjes në seri të llambat elektrike;
- të tregojë rolin e lidhjes paralele;
- të përshkruajë efektin e lidhjes në paralel të llambat elektrike;
- të krahasojë lidhjen në seri dhe lidhjen në paralel të rezistorëve;
- të analizojë qarqet e ndryshme me rezistorë;
- të tregojë gabimet e mundshme në qarqet e ndryshme me rezistorë.

#### **b) Tema e kapitullit**

- Puna dhe energjia elektrike. Efekti termik i rrymës elektrike: Ligi i Xhulit. Fuqia elektrike.
- Qarqet e rrymës së vazhduar. Lidhja paralele e rezistuesve. Ligji i Kirhofit për rryma.
- Lidhja në seri e rezistuesve. Ligji i Kirhofit për tensione. Pjesëtuesi i tensionit.
- Lidhja në seri (metoda e tensionit, rezistenca ekuivalente).
- Lidhja paralele (metoda e rrymave, rezistenca ekuivalente).
- Lidhja e kombinuar (rezistenca ekuivalente).
- Testimi i qarqeve – gabimet (rezistenca ekuivalente – lidhja e shkurtër).

#### **c) Udhëzime didaktike për kapitullin**

Rekomandohet që mësuesi:

- të kryejë punë laboratorike për lidhjet e rezistorëve;
- të angazhojë nxënësit në grupe në zgjidhjen e problemeve gjatë lidhjes së skemave elektrike;
- të kryejë llogaritje të rezistencave ekuivalente, për tensione dhe rryma;
- të bëjë matje të rrymës për qarqe të thjeshta;
- të bëjë matje të tensionit për qarqe të thjeshta;
- të zhvillojë ushtrime laboratorike me poça elektrike (rënia e tensionit).

#### **d) Kushtet për realizimin e kapitullit**

- laborator;
- pankarta;
- projektori;
- makete;
- multimetra.

### **Kapitulli 4: Kondensatorët dhe kapaciteti elektrik**

**18 orë**

#### **a) Qëllimi i kapitullit**

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet:

- të përshkruajë karakteristikat e kondensatorit dhe parimin e punës së tij;
- të dallojë llojet e kondensatorëve;
- të llogarisë kapacitetet ekuivalente të kondensatorit;
- të lexojë vlerat e parametrave të kondensatorit;
- të krahasojë gabimet e mundshme në kondensator në bazë të vlerave të parametrave.

#### **b) Tema e kapitullit**

- Fusha elektrike.
- Kondensatori, llojet e kondensatorëve.

- Lidhja paralele dhe në seri e kondensatorëve.
- Testimi i kondensatorëve.

**c) Udhëzime didaktike për kapitullin**

Rekomandohet që mësuesi të:

- të motivojë nxënësit duke përdorur mjete vizuale;
- të zhvillojë diskutimin ndërmjet nxënësve për fushën elektrike;
- të angazhojë nxënësit në zgjidhjen e problemeve nëpërmjet punës në grupe;
- të kryejë punë laboratorit për kondensatorët;
- të zhvillojë ushtrime numerike për lidhjet në kondensatorë.

**d) Kushtet për realizimin e kapitullit**

- pankarta;
- projektori;
- katalogë;
- makete;
- kondensatorë të ndryshëm;
- faradmetri;
- multimetri.
- Laboratori

**Kapitulli 5: Burimet e tensionit të vazhduar**

**18 orë**

**a) Qëllimi i kapitullit**

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet:

- të shpjegojë parimin e punës të burimeve të ndryshme të rrymës së vazhduar;
- të dallojë burimet e rrymës së vazhduar;
- të tregojë rregullat e lidhjes së burimeve elektrike;

**b) Tema e kapitullit**

- Burimet e tensionit të vazhduar
- Burimet kimike parësore
- Burimet kimike dytësore
- Lidhja në seri dhe paralele e burimeve
- Burimet diellore
- Burimet termike.

**c) Udhëzime didaktike për kapitullin**

Rekomandohet që mësuesi të:

- të motivojë nxënësit duke përdorur mjete vizuale;
- të zhvillojë diskutimin ndërmjet nxënësve lidhur me burimet e rrymës së vazhduar;
- të angazhojë nxënësit në zgjidhjen e problemeve nëpërmjet punës në grupe;
- të kryejë punë laboratorit për kondensatorët;
- të zhvillojë ushtrime numerike për lidhjet në kondensatorë.

**d) Kushtet për realizimin e kapitullit**

- pankarta;
- projektori;
- katalogë;
- makete;

- burime të ndryshme të rrymës së vazhduar;
- multimetri.
- Laboratori

## **Kapitulli 6: Magnetizmi dhe elektromagnetizmi**

**24 orë**

### **a) Qëllimi i kapitullit**

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet:

- të tregojë veçoritë e magnetëve permanentë dhe të elektromagnetëve;
- të shpjegojë parimin e punës të elektromagnetëve;
- të tregojë efektin e fushës magnetike në përçues elektrik;
- të analizojë ndikimin e efektit të rrymës elektrike në dy e më shumë përçues;

### **b) Tema e kapitullit**

- Elektromagnetizmi. Madhësitë magnetike kryesore.
- Fusha magnetike e rrymës elektrike. Bobinat. Elektromagnetët.
- Kuptimi për magnetët permanentë dhe elektromagnetin.
- Fusha magnetike, përçuesit elektrikë në fushën magnetike.
- Induksioni elektromagnetik dhe ndikimi i rrymës elektrike nëpër përçues.
- Mbështjella (bobina) dhe efekti i fushës magnetike.
- Llojet e bobinave.
- Lidhja në seri dhe paralel e bobinave dhe induktiviteti ekuivalent.
- Testimi dhe përdorimi i bobinave.

### **c) Udhëzime didaktike për kapitullin**

Rekomandohet që mësuesi:

- të motivojë nxënësit duke përdorur mjete vizuale;
- të krijojë mundësi që nxënësit të përdorin katalogë me diagrame dhe tabela;
- të nxisë nxënësit nëpërmjet pyetje-përgjigjeve;
- të zhvillojë diskutimin ndërmjet nxënësve për materiale magnetike;
- të zhvillojë ushtrime për magnetët dhe elektromagnetët.
- të nxisë nxënësit nëpërmjet pyetje-përgjigjeve;
- të kryejë punë laboratorit për bobinat;
- të angazhojë nxënësit në grupe në zgjidhjen e problemeve për lidhjen e bobinave;
- të llogaritë induktivitetin ekuivalent;
- të zhvillojë ushtrime për lidhjet në bobina.

### **d) Kushtet për realizimin e kapitullit**

- pankarta;
- projektori;
- katalogë;
- model magneti, elektromagnetit;
- makete materialesh për demonstrim.
- pajisje matëse;

## **Kapitulli 7: Induksioni elektromagnetik dhe bobinat**

**20 orë**

### **a) Qëllimi i kapitullit**

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet:

- të tregojë rolin e induksionit elektromagnetik në pajisjet elektrike;

- të shpjegojë induktivitetin;
- të përshkruajë karakteristikat e bobinës (mbështjellës);
- të dallojë llojet e induktiviteve;
- të krahasojë dhe të dallojë gabimet në bobinë.
- të llogaritë induktivitetin ekuivalent;
- të krahasojë dhe të dallojë gabimet në bobinë.

#### **b) Tema e kapitullit**

- Induksioni elektromagnetik
- Bobinat dhe llojet e tyre
- Ligji i Lencit
- Ligji i Faradejit i induksionit
- Lidhja LR në qarkun e rrymës së vazhduar
- Lidhja në seri dhe paralel e bobinave dhe induktiviteti ekuivalent
- Testimi dhe përdorimi i bobinave

#### **c) Udhëzime didaktike për kapitullin**

Rekomandohet që mësuesi:

- të nxisë nxënësit nëpërmjet pyetje-përgjigjeve;
- të kryejë punë laboratoriale lidhur me përdorimin e bobinave;
- të angazhojë nxënësit në grupe në zgjidhjen e problemeve për lidhjen e bobinave;
- të zhvillojë ushtrime për lidhjet në bobina.

#### **d) Kushtet për realizimin e kapitullit**

- pankarta;
- projektori;
- katalogë;
- makete;
- pajisje matëse;
- laboratoriale.

## Programi i lëndës

### “Vizatim teknik me dokumentacion”

**Lëmi:** Elektroteknikë

**Profili:** Mekatronikë, Energjetikë, Makina elektrike, Informatikë, Telekomunikacion, Komunikime audio dhe video

**Niveli:** I

**Klasa:** 10

#### **I. Qëllimi i lëndës**

Në përfundim të kësaj lënde, nxënësi duhet:

- të dijë rëndësinë e vizatimit teknik dhe të dokumentacionit teknik për industrinë dhe për prodhimtarinë bashkëkohore.
- të dijë të zbatojë standardet e vizatimit teknik
- të ketë të zhvilluar ndjenjën e saktësisë, të përpikërisë dhe të rregullsisë për të bukurën nëpërmjet vizatimit teknik
- të dijë të përdorë llojet e ndryshme të vijave dhe të shkrimit teknik.
- të dijë lexojë, të paraqesë dhe interpretojë vizatimet në shkallë të ndryshme të prezantimit.
- të dijë hartojë dhe interpretojë mënyrat e konstruktimit të figurave të rregullta gjeometrike.
- të dijë të dallojë simbolet e ndryshme elektrike dhe elektronike në skema dhe të dijë të vizatojë dhe të interpretojë ato

#### **II. Fondi i orëve të lëndës**

35 javë x 2 orë/javë=70 orë

#### **III. Programi i hollësishëm i lëndës**

##### **Kapitulli 1: Hyrje. Veglat dhe standardet e vizatimit teknik**

**6 orë**

##### **a) Qëllimi i kapitulli**

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet:

- të dijë rëndësinë e vizatimit teknik dhe të dokumentacionit teknik për industrinë dhe për prodhimtarinë bashkëkohore;
- të njohë standardet e vizatimit teknik
- të njohë veglat e ndryshme për vizatim teknik dhe të dijë të përdorë ato.

##### **b) Tema e kapitullit**

- Rëndësia e vizatimit teknik dhe e dokumentacionit teknik për industrinë dhe për prodhimtarinë bashkëkohore
- Standardet, formatet, tabelat (legjendat) dhe matjet në vizatimin teknik
- Veglat për vizatim teknik dhe përdorimi i tyre

##### **c) Udhëzimi didaktik për kapitullin**

Rekomandohet që mësimdhënësi :

- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të standardeve të vizatimit teknik

**d) Kushtet për realizimin e kapitullit**

- Klasa
- Modele të simboleve elektrike

**Kapitulli 2: Llojet e vijave dhe të shkrimit teknik**

**14 orë**

**a) Qëllimi i kapitullit**

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të dijë:

- të dallojë llojet e ndryshme të vijave dhe të shkrimit teknik dhe t'i përdorë ato si duhet.

**b) Tema e kapitullit**

- Llojet e vijave dhe përdorimi i tyre
- Shkrimi teknik
- Materialet dhe simbolizimi i tyre në vizatimin teknik

**c) Udhëzimi didaktik për kapitullin**

- Të shpjegojë njohuri të reja
- Rekomandohet që mësuesi të shpjegojë shembuj me formatet, tabelat dhe matjet e vijave.
- Të ushtrohet shkrimi teknik.

**d) Kushtet për realizimin e kapitullit**

- Klasa
- Veglat për vizatim teknik.

**Kapitulli 3 :Konstruktimi i figurave gjeometrike**

**16 orë**

**a) Qëllimi i kapitullit**

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të dijë:

- të zbatojë standardet e vizatimit teknik;
- të konstruktojë figura të ndryshme gjeometrike;
- të bëjë kuotimin (dimensionimin) e figurave të vizatuara

**b) Tema e kapitullit**

- Niveli numerike e një vizatimi teknik
- Kuotimi (dimensionimi)
- Konstruktimi i figurave të rregullta gjeometrike.

**c) Udhëzimi didaktik për kapitullin**

- Rekomandohet që mësuesi të zbatojë përdorimin e vijave në shembuj me figura gjeometrike.
- Ta njohë nivelin numerike të një vizatimi teknik

**d) Kushtet për realizimin e kapitullit**

- Klasa
- Veglat për vizatim teknik.

**Kapitulli 4 : Simbolet dhe skemat elektrike dhe elektronike**

**17 orë**

**a) Qëllimi i kapitullit**

Në përfundim të kapitullit, nxënësi duhet të dijë:

- të lexojë, të paraqesë dhe interpretojë vizatimet në shkallë të ndryshme të prezantimit.
- të dallojë dhe të vizatojë simbolet dhe skemat e caktuara elektrike dhe elektronike.

**b) Tema e kapitullit**

- Simbolet elektrike për skemat
- Simbolet e komponenteve elektronike
- Skemat elektrike dhe elektronike

**c) Udhëzimi didaktik për kapitullin**

- Rekomandohet që mësuesi të shpjegojë skemat dhe simbolet e komponenteve elektronike

